



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	15.06.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Yllka Syla
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, Zënjare për hapësira publike <i>Hartohi</i>
	<input checked="" type="checkbox"/> Kontrollloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Yllka Syla me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike pllatoja e sheshit, “Zahir Pajaziti” afër Hotel Grand dhe Kino Armatës me datë 20 Qershor 2021 nga ora 16:00 deri në 19:00.

Qëllimi i kërkesës është shënimi i Ditës së Baballarëve.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 20 Qershor 2021 nga ora 16:00 deri në 19:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.